



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 2404 Prot.

Tiranë, më 18.09.2024

VENDIM

Nr. 126, datë 18.09.2024

PËR

HAPJES E THIRRJES PËR APLIKIME PËR STUDENTËT TË CIKLIT TË DYTË
PRANË UNIVERSITETIN E ROMËS "FORO ITALICO", ITALI,
NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

Mbështetur në Marrëveshjen Ndërinstitucionale për Programin ERASMUS+ të nënshkruar midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit të Romës "Foro Italico",

VENDOSA:

1. Hapjen e thirrjes për aplikime për 3 (tre) bursa për *studentët e ciklit të dytë të studimeve (Master Shkencor / Master Profesional)* në kuadër të Programit ERASMUS+ pranë *Universitetit të Romës "Foro Italico"* sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Koordinatori Akademik për Programin ERASMUS+ të mobiliteteve Dr. Elona MEHMETI së bashku me Drejtorinë e Marrëdhënieve më Jashtë, Publikut dhe Studentëve për ndjekjen dhe mbarvatjen e të gjitha procedurave.
3. Ngarkohet Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikut dhe Studentëve për publikimin e thirrjen në faqen zyrtare të universitetit dhe rrjetet sociale zyrtare.
4. Perzgjedhja e kandidaturave do të realizohet nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. Agron KASA



Hapet thirrja për 3 (tre) bursa për aplikime për studentët e ciklit të dytë të studimeve (Master Profesional / Master Shkencor) në Universitetin e Romës "Foro Italico", në Itali, në kuadër të programit Erasmus+ për vitin 2024-2025

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për 3 (tre) bursa për aplikime për mobilitete për studentët e ciklit të dytë të studimeve (Master Profesional / Master Shkencor) në Universitetin e Romës "Foro Italico", në Itali për vitin 2024-2025.

<https://www.uniroma4.it/index.php/relazioni-internazionali/erasmus-programme/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të ciklit të dytë për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Master Profesional / Master Shkencor;

Studentët aplikues duhet të plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë studentë i regjistruar në programet e studimit të ciklit të dytë pranë UST;
2. Të kenë njohje të mirë të gjuhës angleze. Studentët me njohje të mirë *edhe* të gjuhës italiane kanë përparësi;
3. Të kenë performancë të mirë akademike

Kohëzgjatja e bursave:

- Një semestër

Fushat e shkëmbimit:

Bursat/mobilitetet,do të jenë në fushat si vijon:

- Veprimtarisë fizike dhe shëndeti

Bursat përfshijnë:

- *Kompensimin prej 800 në muaj*

- *Kostot e udhëtimit* (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

Për të përcaktuar distancën ju lutem referojuni link-ut:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

Studentë që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.

Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV në gjuhën angleze/italiane;
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe)
- Listë notash të nivelit aktual dhe të mëparshme të studimit (në gjuhën shqipe)
- Letër motivivimi në gjuhën angleze/italiane;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht/Italisht);

Afati për aplikim: 30 shtator 2024

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi deri më 30 shtator 2024, pranë Zyrës së Protokollit në UST dhe të dërgohen të skanuara në adresën e-mailin erasmus@ust.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën; erasmus@ust.edu.al

Universiteti i Sporteve të Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!